




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	05.11.2020	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
S.K.P.H.S.H.E.K	2486	2020	1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova**  
**Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo**

A. Nr. 267/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi – Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani, anëtar dhe Jeton Koci - anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.267/2020, të datës 15.09.2020, së ankuesit ██████████, me adresë banimi rruga „Blinishtë”, nga Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.11.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET si e bazuar** ankesa A. Nr. 267/2020, e datës 19.09.2020, e parashtuar nga ankuesi ██████████.
- II. ANULOHET** procedura e rekrutimit sipas konkursit të datës 30.06.2020, e shpallur nga Komuna e Obiliqit për pozitën „Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Projekteve” në Komunën e Obiliqit.
- III. OBLIGOHET** Kryetrari i Komunës së Obiliqit dhe Menaxheri i Personelit, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**Arsyetim**

Komuna e Obiliqit bazuar në autorizimin e datës 26.06.2020 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 30.06.2020, ka shpallur konkursin e jashtëm për pozitën e lire të punës „Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Projekteve” në Drejtorinë e Inspektionit.

Ankuesi ██████████, ka aplikuar në konkursin e lartpërmendur të shpallur nga Komuna e Obiliqit, për pozitën „Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Projekteve” në Drejtorinë e Inspektionit i njëjti është kualifikuar për të hyrë në listë të ngushtë dhe është ftuar në test me shkrim dhe me gojë.

Ankuesi ██████████, i pakënaqur me njoftimin e publikuar nga Komuna e Obiliqit, të datës 25.08.2020, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën „Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Projekteve” në Drejtorinë e Inspektionit, në Komunën e Obiliqit me datën 27.08.2020, ka parashtruar ankesë direkt në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Obiliqit.

Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Obiliqit me datën 28.08.2020, për mes Njoftimi e ka njoftuar ankuesin se duke u bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr. 06/L-144, për Zyrtarët Publik, keni të drejtë të parashtroni ankesë direkt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrësen për Shërbimin Civil të Kosovës,

Ankuesi ██████████ në përputhje me Ligjit Nr. Nr. 06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 15.09.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1760/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 21.09.2020, me numër protokoll 1830/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Obiliqit, ndërsa me datën 02.10.2020 me numër protokoll 1957/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Obiliqit, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A nr.267 /2020 e datës 15.09.2020, me numër protokoll 1760/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 30.06.2020; Njoftimi i datës 03.08.2020; Njoftimi i datës 25.08.2020; Ankesë e datës 27.08.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimi i datës 28.08.2020; Autorizimi i datës 26.06.2020, i Ministrisë së Administratës Publike/ Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil; Vendimi i datës 29.07.2020; Vlerësimi Individual i Kandidateve për Vendin e Punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Testi me shkrim; Kërkesa për punësim e Elbasan Kolshi, me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 18.03.2015; referencë e datës 30.05.2019; Vërtetimi i datës 03.06.2019; Kërkesa për punësim e Valon Aliu, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 14.08.2017; Diplomë e datës 16.11.2012; Përgjigje në ankesë e datës 02.10.2020, me numër protokoll 1957/2020, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankuesit ██████████, është e bazuar, për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale në procedurën e rekrutimit për pozitën „Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Projekteve” në Komunën e Obiliqit sipas konkursit të shpallur të datës 30.06.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se konkursi për „Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Projekteve”, në Drejtorinë e Inspektionit ka qenë i publikuar nga data 30.06.2020 deri me datën 14.07.2020, dhe është vazhduar edhe për shtatë (7) ditë, nga data 15.07.2020, deri me datën 21.07.2020, ndërsa Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil listën e shkurtër e ka përgatitur në kundërshtim me dispozitat e nenit 26 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Përgatitja e listës së shkurtër zhvillohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas afatit të fundit të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit”**, çka nënkupton se lista e shkurtër është përgatitur me datë 03.08.2020 jashtë afatit ligjor, respektivisht pasi kanë kaluar më shumë se pesë (5) ditë pune prej momentit kur është mbyllur konkursi.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 30.06.2020 nga Komuna e Obiliqit për pozitën „ Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Projekteve” ,në Komunën e Obiliqit, kriteret e konkursit kanë qenë:

- **Diplome Universitare drejtimi Inxhinier i Diplomuar ose Master i ndërtimtarisë**
- **Se paku tri (3) vite përvojë punë**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmime të ofruara nga autoriteti punëdhënës dhe ankuesi për kualifikimin dhe përvojën e punës të bashkëngjitura në dosjen e kandidatit të përzgjedhur dhe në dosjen e ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka dështuar të vlerësoj drejtë dëshmitë e kualifikimit për kandidatin e përzgjedhur, sepse kandidati i përzgjedhur Valon Aliu nuk e ka plotësuar kriterin e *arsimimi dhe kualifikimi profesional* ashtu siç është kërkuar në konkurs. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dëshmime të ofruara nga autoriteti punëdhënës ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur Valon Aliu posedon Diplomë Universitare me numër Nr. 354 të datës 16.11.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës , me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, drejtimi „Komunikacion” me date 09.11.2012 dhe ka fituar titullin „Bachelor i Komunikacionit Rrugor” si dhe posedon Diplomën me Nr. 282 të datës 29.08.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se me datën 14.07.2017 ka përfunduar studimet Master në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike departamenti i Komunikacionit dhe ka fituar titullin „Master i Shkencave të Inxhinierisë Mekanike”. Andaj Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përzgjedhjes së Valon Aliut si kandidat i suksesshëm i cili nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas konkursit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se *„Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim: 1.1. arsimimi dhe kualifikimi profesional; dhe 1.2. përvoja e punës”*.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marrë parasysh shkeljet procedurale të theksuara më lartë, konstaton se procedura e rekrutimit e zhvilluar nga Komuna e Obiliqit, është bërë në kundërshtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *„Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Obiliqit, në lidhje me zhvillimin e procedurave të rekrutimit si dhe përzgjedhjen e kandidatit ka vepruar në kundërshtim me neni 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku thuhet se: *„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”*.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.



Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

***Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda Nr. A. Nr. 267/2020***

**Rushit Kajtazi**

Procesmbajtës

**Malsore Gashi Bajraktari**

Kryetare e Kolegjit

***Vendimi i dërgohet:***

- Ankuesit ██████████
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit;
- Arkivit të KPMSHCK-së